

VENDIM
Nr. 239, datë 21.3.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 343, DATË 22.4.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
LINJËS SË TRANSMETIMIT 110 kV, UZNOVË–ÇOROVODË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tabelën bashkëlidhur vendimit nr. 343, datë 22.4.2015, të Këshillit të Ministrave, nga lista e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen për interes publik, hiqet pasuria me numër rendor 29, shtylla 45, numër pasurie 32/16, zona kadastrale 3019, NB Poliçan.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama